

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË

Ma. Vjosa Osmani

**NUANCA GJINORE NË GJUHËN
E FEMRAVE**

PUNIM I DOKTORATËS

Prishtinë, 2019

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"

FACULTY OF PHILOLOGY

Ma. Vjosa Osmani

**GENDER NUANCES IN WOMEN'S
LANGUAGE**

DOCTORAL THESIS

Prishtina , 2019

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA. VJOSA OSMANI

**NUANCA GJINORE NË GJUHËN
E FEMRAVE**

PUNIM I DOKTORATËS

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Shkumbin Munishi

Prishtinë, 2019

REZYME

Në këtë punim është trajtuar mënyra e komunikimit të femrave, përzgjedhjet gjuhësore që i bëjnë ato, funksionet e atyre përzgjedhjeve, si dhe faktorët shoqërorë, që ndikojnë në sjelljen gjuhësore, e së këndejmi edhe në pozitën e tyre në shoqëri. Në këtë kontekst janë trajtuar edhe problemet shoqërore që mund të lindin për shkak të gjuhës, si: pabarazia gjuhësore, si shkak i pabarazisë shoqërore, ose si rrjedhojë e saj, barrierat, paragjykimet, stereotipat si burim potencial i paragjyqimeve etj. Me fjalë të tjera, është synuar të shihet mënyra se si femrat e menaxhojnë sjelljen e tyre gjuhësore, apo çfarë strategjish përdorin që t'u përshtaten normave a parimeve të mentalitetit shoqëror, e si rrjedhojë e kësaj t'i ruajnë ose t'i krijojnë pozicionet e caktuara në shoqëri.

Një analizë e tillë është bërë duke u mbështetur në metoda të ndryshme, kryesisht mbi bazën e vëzhgimeve të drejtpërdrejta të bisedave të femrave dhe meshkujve, të zhvilluara në kontekste të ndryshme, por edhe në metoda të tjera, përmes të cilave është përshkruar gjuha e femrave, janë parë dallimet në mes tyre dhe meshkujve, janë parë lidhjet midis organizimit të gjuhës dhe faktorëve socialë si dhe problemet tjera shoqërore, që mund të lindin për shkak të gjuhës.

Verifikimi i të dhënave të mbledhura është bërë edhe nëpërmjet pyetësorëve a anketave të ndryshme sociolinguistike, përmes të cilave. jo vetëm që janë hetuar dallimet gjuhësore, por janë nxjerrë edhe rezultate për stereotipat, paragjykimet e etiketat seksiste, për vlerësimet apo pranueshmërinë e këtyre stereotipave dhe etiketave, reagimet e personave të etiketuar dhe ndikimin që kanë ato në suksesin, e së këndejmi edhe në pozitën e tyre në shoqëri. Me një fjalë, me anë të kësaj metode është synuar të identifikohen mënyrat se si portretizohen femrat përmes këtyre njësive përcaktuese.

Shembujt që janë përdorur në këtë punim, për të testuar gjuhën e femrave janë marrë nga responentë të gjinive të ndryshme, të moshave të ndryshme, si dhe të niveleve të ndryshme arsimore, konkretisht nga biseda të zhvilluara në ambiente të ndryshme: shkollore, familjare, shoqërore, emisione televizive etj.

Për t'u dhënë zgjidhje këtyre çështjeve fillimisht është dhënë një pasqyrë e përgjithshme mbi gjuhën e femrave si dhe mbi perspektivat nga të cilat është trajtuar ajo, si nga studiuesit e huaj ashtu edhe ata shqiptarë. Duke u mbështetur në këto studime, është ndërtuar baza teorike, për të vazhduar pastaj trajtimin e gjuhës së tyre në korpusin e marrë në shqyrtim.

Përmes analizës së teksteve, vëzhgimeve të drejtpërdrejta, si dhe anketave të bëra me subjekte të gjinive dhe të moshave të ndryshme, janë nxjerrë këto përfundime:

- Dallimet në mes të femrave dhe meshkujve janë të rrafshve të ndryshme: fonetike (intonacioni, ritmi, cilësia e zërit, theksi etj.), morfologjike (foljet, përemrat, mbiemrat, ndajfoljet, pjesëzat, pasthirrmat etj.), sintaksore (llojet e fjalive etj.), leksikore e stilistike (urimet, mallkimet, betë, fjalët fyese, fjalët e shprehjet e mirësjelljes e të kërkimfaljes, eufemizmat, fjalët e shprehjet kërcënuese, fjalët e shprehjet me ngjyime emocionuese, fjalët me kuptime të figurshme etj.) e të ndërtimit të tekstit a të bisedës në përgjithësi (të radhës në bisedë, ndërprerjes së bisedës, dendurisë së të folurit etj.).

- Femrat dhe meshkujt i përdorin format e caktuara gjuhësore për të arritur efekte a qëllime të ndryshme gjatë komunikimit. Kështu, derisa femrat përdorin më shumë njësi gjuhësore që shprehin solidaritet, pasiguri, dyshime, pranueshmëri, mirësjellje, konfuzitet, ngurrim, qëndrim të pavendosur, mungesë vendosmërie, lëkundje, mbështetje konfirmuese, përpikëri, saktësi, ndrojtje, modesti, ndjenja a qëndrime emocionale (zemërim, frikë, dhimbje, dëshpërim, habi, dashuri, gëzim, kënaqësi, mallëngjim a ngashërim, keqardhje, ironi, entuziazëm, turp, frikë etj.), ndjenja estetike etj., meshkujt përdorin më shpesh njësi gjuhësore, të cilat shprehin pushtet- autoritet, siguri, ashpërsi, kërkesa të prera etj.

- Pushteti dhe solidariteti manifestohen përmes veçorive të caktuara gjuhësore: fonetike/fonologjike (dallimeve në ngritjen, uljen e forcën e zërit, dallimeve në mënyrën e shqiptimit a të theksimit të fjalëve, dallimeve në shpejtësinë e shqiptimit të tyre etj.), morfologjike (mënyrave të foljeve, mbiemrave, ndajfoljeve, pjesëzave, pasthirrmave etj.), sintaksore (fjalive thirrmore, fjalive pyetëse-veçanërisht fjalive pyetëse-retorike, fjalive nxitëse kategorike, fjalive nxitëse të zbutura, përgjigjeve minimale, fjalive pohore që shprehin pasiguri, frazave shpjeguese dhe modifikuese, fjalive të thjeshta dhe të paplota-eliptike etj.), leksikore dhe

stilitike (mallkimeve, urimeve, beve, fjalëve tabu, eufemizmave, fjalëve e shprehjeve të mirësjelljes dhe të kërkimfaljes, fjalëve e shprehjeve kërcënuese etj.), të ndërtimit të tekstit a të bisedës (ndërtimit të radhës, ndërprerjes së radhës, dendurisë së të folurit etj.)

- Femrat përdorin më shumë forma të komunikimit jo të drejtpërdrejtë, ndërkaq, meshkujt forma të komunikimit të drejtpërdrejtë. Këto mjete të komunikimit ato i përdorin për të arritur synime të ndryshme: të flasin në mënyrë sa më korrekte, më të plotë, më me mirësjellje e më të pëlqyeshme për bashkëbiseduesit, të tërheqin vëmendjen, të ndikojnë tek të tjerët, të argëtohen a të përqeshin dikë, të thonë gjëra, që, për arsye të ndryshme, kryesisht për të mos thyer kodin social apo kodin etiko-moral, nuk mund t'i thonë drejtpërdrejt, e në këtë mënyrë të arrijnë t'i mbulojnë zbrazëtitë shprehëse, që mund të krijohen për shkak të këtyre sistemeve të normave. Duke iu përshtatur normave a parimeve morale, arrijnë ta krijojnë apo ta ruajnë një imazh sa më të mirë në shoqëri.

- Femrat përdorin më shpesh sesa meshkujt fjalë e shprehje eufemistike. Ndër më të zakonshmet dalin ato që i pasqyrojnë botëkuptimet magjike-mistike për botën dhe dukuritë e jetës shpirtërore e psikike të njeriut, eufemizmat e formuar mbi bazën e dogmave apo paragjykimeve mistike-fetare, eufemizmat që lidhen me procese a sëmundje të ndryshme, e veçanërisht eufemizmat që i zëvendësojnë fjalët tabu. Nga gjithsej 72 njësitë e tilla, sa janë gjetur në korpusin e këtij studimi, 65% janë përdorur nga femrat, ndërkaq, 35% nga meshkujt. Shumicën prej shprehjeve eufemistike të identifikuara, konkretisht 73%, femrat i kanë përdorur për të zëvendësuar pjesë të caktuara intime të trupit, shtatzëninë, menstruacionet, nevojat fiziologjike, seksualitetin etj. Ndërkaq, janë përdorur shumë më pak, gjithsej 27%, eufemizma që lidhen me besimin në fuqitë hyjnore e të mbinatyrshme, me procese a sëmundje të ndryshme.

Natyrisht, edhe femrat, sikurse meshkujt, përdorin fjalë e shprehje, përmes të cilave u vënë nofka, i fyejnë apo shprehin mendime të këqija për të tjerët. Megjithatë, fjalët e shprehjet e tilla ndryshojnë nga fyerjet, që përdorin meshkujt, si nga përmbajtja, ashtu edhe nga rrethanat e përdorimit. Këto njësi i përdorin më shumë femrat me nivel më të lartë arsimor, femrat me status më të ulët social, moshat e reja dhe femrat e moshuara, ndërkaq, shumë më rrallë femrat e moshës mesatare, ato me nivel të ulët e të mesëm arsimor, si dhe femrat me status të lartë social. Pra, përdorimi i fjalëve tabu, përveç me gjininë, lidhet edhe me statusin social, moshën e folësit,

kontekstin e komunikimit, si dhe me marrëdhëniet në mes të personave të përfshirë në komunikim.

- Femrat përdorin më shpesh sesa meshkujt ironinë, si formë të komunikimit të tërthortë, sidomos në rastet kur shprehin zemërim, përbuzje, mospërfillje, pakënaqësi, nënvlerësim, urrejtje etj. Këtë formë të komunikimit e realizojnë kryesisht përmes pasthirmave emocionuese, prapashtesave të zvogëlimit të shoqëruara me një ndjenjë përçmimi etj.

- Gjuha e femrave është e mbushur edhe me fjalë me kuptime të figurshme, si forma të komunikimit jo të drejtpërdrejtë, veçanërisht me: krahasime, hiperbola, litota, epitete, personifikime etj. Përmes këtyre njësive ato synojnë ta japin një fotografi sa më të qartë për gjërat që thonë, në mënyrë që t'i bëjnë më të kuptueshme e më të kapshme për bashkëbiseduesit, të theksojnë mendimin, të lënë përshtypje më të madhe për diçka etj.

- Femrat dallohen nga meshkujt edhe nga mënyra se si i shprehin kërkesat, apo si u drejtohen të tjerëve, për të kryer një veprim a për të zgjidhur një problem. Kështu, meshkujt përdorin më shpesh stilin e komunikimit të drejtpërdrejtë, të realizuar përmes fjalive nxitëse kategorike, ndërkaq, femrat janë më të prira të përdorin stilin e komunikimit të tërthortë, të realizuar përmes fjalive nxitëse jokategorike-të zbutura, megjithëse fjalitë e tilla jo rrallë hasen edhe në gjuhën e meshkujve, sidomos në rastet kur synojnë të duken se kanë qëndrim më të butë, t'i shembin barrierat e të jenë më afër bashkëbiseduesve, apo audiencës, e në këtë mënyrë të ndikojnë më shumë tek ajo.

- Përdorimi i fjalive nxitëse kategorike apo të zbutura lidhet më shumë me kontekstet e komunikimit, me rolin që kanë folësit në këto situata, me marrëdhëniet në mes tyre, me qëndrimin afektiv ndaj asaj që thonë a kërkesës që bëjnë, pra me gjendjen e tyre ndjesore, si dhe me autoritetin që gëzojnë. Për shkak se meshkujt, në shumicën e rasteve, ndodhen në pozita më të larta hierarkike e janë më autoritarë, fjalitë nxitëse kategorike, përmes të cilave jepen urdhra të drejtpërdrejta, të padiskutueshme a kategorike, janë më tipike për ligjërimin e tyre. Megjithatë, meqenëse autoriteti nuk arrihet vetëm nga pushteti, apo forca detyruese për të ushtruar pushtet tek të tjerët, për t'i bindur a detyruar ata t'u përgjigjen thirrjeve a kërkesave tona, por në shumë raste lidhet me nderin, respektin dhe besimin, që ekziston në mes të anëtarëve të një grupi, marrëdhëniet sociale të pabarabarta të pushtetit ose të varësisë, nuk janë gjithmonë arsye për përdorimin e stilit të komunikimit jo të drejtpërdrejtë. Përkundrazi, në shumë raste, plotësimi i një kërkesë, pa e bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë, del si shenjë e fuqisë, dhe jo e mungesës së saj,

por, edhe si sistem komunikues, përmes të cilit të dyja palët synojnë ta ruajnë respektin e imazhin.

- Femrat janë më të prira të përdorin varietetin standard, ndërkaj meshkujt atë jostandard. Faktorët që ndikojnë në përdorimin e njërit apo të tjetrit varietet janë të natyrave të ndryshme. Ato e përdorin më shumë gjuhën standarde, që ta ruajnë distancën e tyre me personat zyrtarë, të tregohen më të kujdesshme, të tregojnë më shumë respekt, të lënë përshtypje më të mira, të ngjallin bindje e besim se janë kompetente, të vlerësohen më mirë nga të tjerët, ta përmirësojnë imazhin, e së këndejmi ta rregullojnë pozitën e tyre në shoqëri. Kjo do të thotë se, një përzgjedhje e tillë ndodh nën tryshninë e standardeve të ndryshme, përmes të cilave vlerësohen meshkujt dhe femrat. Derisa meshkujt, vlerësohen më shumë për profesionin apo aftësitë që kanë, e njëjta gjë nuk vlen edhe për femrat. Ato vlerësohen më shumë për veçori të tjera të statusit, duke përfshirë edhe mënyrën e të folurit.

- Ndërprerja e bisedës (mbivendosja), të folurit e shumë apo heshtja varen nga një sërë faktorësh. Ato nuk shfaqen gjithmonë si përpjekje e folësve për të treguar pushtet mbi bashkëbiseduesit. Në shumë raste ndërprerjet e fjalës varen nga: kompetenca komunikuese e folësit (folësit nuk kanë njohuri të mjaftueshme për të dhënë fakte për problemin që diskutohet, apo nuk i njohin strategjitë verbale dhe joverbale të komunikimit, të cilat e rrisin efikasitetin e komunikimit), qëllimet të cilat synojnë t'i arrijnë bashkëbiseduesit gjatë diskutimit (folësit e ndërprejnë qëllimshëm palën tjetër, duke mos i lënë hapësirë t'i shpalos idetë e tij), gjendja e tyre emocionale (folësit, ose nuk arrijnë t'i shprehin qartë idetë e tyre, ose e përshpejtojnë ritmin e të folurit), çështjet kulturore (respekti për bashkëbiseduesit), raportet ndërmjet folësve (qëndrimi që folësit mbajnë kundrejt njëri-tjetrit, respekti dhe autoriteti i folësve të përfshirë në bisedë) etj.

- Stereotipat dhe etiketat seksiste ndaj femrave, dhe probleme të tjera që ndërliken me to, si: paragjykimet e stigmatizimi janë, po ashtu, më të zakonshme për femrat sesa për meshkujt. Ato në shumë raste janë rrjedhojë e bindjeve të pandërgjegjshme, meqenëse, jo rrallë, krijohen, barten brez pas brezi, pavetëdijshëm, duke u pranuar si vlerësime të vërteta a të drejta për individë dhe grupe të ndryshme, e veçanërisht për femrat. Megjithatë, shumica e tyre janë produkt i bindjeve të ndërgjegjshme, që i krijojnë njerëzit për këto kategori. Për shkak se njësitë e tilla burojnë nga mendimet filozofike, morale, fetare, estetike të shtresave të caktuara

shoqërore, ato pasqyrojnë interesat dhe qëndrimet e këtyre shtresave. Prandaj, vlerësimet e mbështetura në pikëpamjet e tilla jepen për të arritur qëllime të ndryshme: për të kontrolluar, për të shtypur, për të përçmuar, për të fyer e mbi të gjitha për të shprehur superioritet ndaj të tjerëve.

- Duke u mbështetur në përmbajtjen e stereotipave dhe etiketave për femrat, të nxjerra nga korpusi i këtij punimi, është arritur në përfundim se shumica nga to bartin në vete bindje a qëndrime negative për to. Madje, shumica nga njësitë e tilla i shprehin në mënyrë mjaft eksplicite këto qëndrime, si: urrejtje, përbuzje, zemërim, sharje, ironi, tallje, dëshpërim, përçmim, pakënaqësi, zhgënjim, mosbesim, armiqësi, zili, xhelozzi, neveri e shumë qëndrime tjera mospërfillëse për feramat. Rezultatet e nxjerra tregojnë se femrat vlerësohen më shpesh si: intrigante, besnike, dinake, kureshtare, tekanjoze, emocionale, të ndershme, të drejta, të dashura, të moralshme, të sjellshme, bashkëpunuese, miqësore, të nënshtruara, naive, të buta, të pavendosura, grindavece, flasin shumë, flasin më me mirësjellje, bëjnë më shumë thashetheme, flasin jodrejtpërdrejtë, ndërpresin më shumë bisedën, ndërkaq, meshkujt portretizohen më shpesh si: inteligjentë, konkurrues, ambiciozë, logjikë, të fortë, parimorë, dominues, shfrytëzues, mashtrues, arrogantë, materialistë, vigjilentë, organizativ, të suksesshëm, të prerë, të pavarur, të guximshëm, të rreptë, agresivë, inatçorë etj.

- Stereotipat dhe etiketat e tilla negative, ideologjikisht arsyetojnë inferioritetin e femrave në shoqëri. Prandaj, përmes këtyre njërive gjuhësore folësit synojnë të hedhin poshtë vlerën a dobinë e tyre, e së këndejmi, t'i vënë ato në pozita më të ulëta shoqërore.

- Stereotipat dhe etiketat në tekstet e marra në shqyrtim, veçanërisht në ato të folklorit, nuk janë thjesht ofenduese. Përkundrazi, ato janë thirrje për injorim, përbuzje, përçmim, pabarazi, diskriminim, stigmatizim e dhunë ndaj femrave. Për këtë arsye, stereotipat dhe etiketat e tilla kanë ndikim të madh në rritjen e qëndrimeve seksiste. Prandaj, një ndër faktorët, që luan rol të madh në rritjen e paragjytimeve e stigmatizimit, mund të jetë pikërisht ekspozimi ndaj mesazheve diskriminuese, që përçojnë këto tekste për femrat.

- Stereotipat dhe etiketat në tekstet e marra në shqyrtim nuk bazohen gjithmonë në qëndrime e vlerësime negative për femrat. Në disa raste ato mbështeten në dashamirësi, përkëdhelje, admirim, mirënjohje, dhembshuri, lavdërim a dashuri për to. Mirëpo, edhe në situata të tilla, ato bëjnë një ndërlidhje në mes të trajtimit inferior dhe vlerësimit pozitiv për femrat. Kjo do të thotë se në cilindo rast, pavarësisht se u referohen femrave, që bartin role të ndryshme, në përgjithësi japin një pasqyrë të pozitës së tyre inferiore në shoqëri. Kështu, përdorimi i fjalëve që

shprehin dashuri a përkëdhelie, në situata formale (e dashur, baby, zemër etj) është diskriminues. Janë diskriminuese e fyese, meqenëse, përmes tyre synohet të arrihet afri a intimitet.

- Përceptimet e shkalla e stereotipave është e lidhur ngushtë me njohuritë që kanë individët për kategori të caktuara shoqërore. Sa më pak që kanë njohuri, për dikë a diçka, aq më të prirë janë t'i përgjithësojnë e t'i paragjykojnë të tjerët. Gjatë hulumtimit është vënë re se edhe vetë femrat që nuk kanë bërë ndonjë karrierë të caktuar kanë më shumë paragjykime për femrat që kanë pozita të larta në shoqëri, prandaj stereotipat janë më të zakonshme në mes të grupeve të ndryshme sesa brenda të njëjtit grup, pikërisht për shkak të mungesës së këtyre informatave. Ky fakt është një tregues i qartë se stereotipat ndikojnë në sjelljet, gjykimet e vlerësimet tona. Me fjalë të tjera, stereotipat kanë forcë të kontrollojnë apo diktojnë sjelljet tona, por edhe gjykimet e vlerësimet tona për dikë a diçka.

- Ekzistojnë dallime të theksuara në atributet që u vishen femrave të kategorive të ndryshme: të moshave të ndryshme, të niveleve të ndryshme arsimore dhe të shtesave të ndryshme regjionale e sociale. Kështu, të njëjtat femra portretizohen apo vlerësohen në mënyra të ndryshme. Kjo do të thotë se, përveç me gjininë, stereotipat dhe etiketat e tilla lidhen ngushtë edhe me faktorë të tjerë, siç janë: moshja, arsimimi, prejardhja, gjendja sociale etj.

- Gjatë hulumtimeve është vënë re se rubrikat e politikës, ekonomisë, sportit dhe opinioneve/editorialeve, fusha këto, në të cilat femrat shihen si jokompetente, pasqyrojnë më së miri dallimet e madha në pozicionet e femrave dhe meshkujve, jo vetëm në media, e në këto fusha, por edhe në shoqëri përgjithësisht, duke qenë se mediat vetëm pasqyrojnë gjendjen reale të pozitës së tyre në shoqëri. Me fjalë të tjera, kjo shpërndarje i pasqyron mjaft qartë, por edhe i përforcon, stereotipat e njohura tashmë, të cilat i portretizojnë femrat si udhëheqëse më të dobëta sesa meshkujt, më pak të afta në politikë, në veprimtari, në të cilat nevojitet fizik më i fortë (sport), si dhe në dhënien e gjykimeve a vlerësimeve për çështje të caktuara. E në anën tjetër, prania shumë e madhe e femrave në rubrikën e show-bizz-it është një tregues i qartë se ato shihen si më të denja për botën e argëtimit. Me fjalë të tjera, kjo tregon se femrat, në shumicën e rasteve, trajtohen në planin argëtues dhe erotik, e më rrallë në atë profesional.

- Stereotipat dhe etiketat që u vihen femrave vlerësohen më negativisht sesa ato që u vihen meshkujve. Rezultatet e nxjerra nga anketat e bëra për pranueshmërinë apo vlerësimin që u bëhet këtyre tipareve stereotipe, tregojnë se nga 44 tiparet, sa janë dhënë gjithsej, 25 nga to dalin pozitive (12 tipare që vlerësohen tipike për femrat dhe 13 tipare që vlerësohen tipike për

meshkujt), 18 vlerësohen si negative (11 karakteristike për femrat dhe 7 për meshkujt), ndërkaq 1 tipar konsiderohet neutral (i përbashkët për të dyja gjinitë). Kjo tregon se tiparet stereotipe dhe etiketat që u vihen femrave vlerësohen më negativisht (61%), se ato që u vihen meshkujve (39%). Ndërkaq, nga gjithsej 25 tiparet pozitive 48% nga to u vihen femrave dhe 52% meshkujve.

Duke u mbështetur në të gjitha këto rezultate, krejt në fund mund të thuhet se dallimet gjuhësore në mes të femrave dhe meshkujve pasqyrojnë marrëdhëniet shoqërore, si dhe formohen e ndryshojnë në përputhje me ndryshimin e këtyre raporteve. Këto dallime janë të natyrave të ndryshme: kulturore, të vullnetit, të qëndrimit personal, pasigurisë, autoritetit, gjendjes së tyre emocionale, mënyrës së jetesës, vlerësimit, faktorëve shoqërorë (familjes, rrethit shoqëror, shkollës, si dhe parimeve e standardeve të tjera të mentalitetit) etj.

Tekstet e femrave u përshtaten dhe pasqyrojnë realitetin shoqëror, aq sa edhe synojnë ta ndërtojnë atë. Me fjalë të tjera, sjellja e tyre gjuhësore është shprehje e mënyrës së jetesës, e vetëdijes botëkuptimore, e traditave, e mendësisë, e karakterit, e arsimimit, e normave, e parimeve të mentalitetit shoqëror etj. Kjo vetëdije botëkuptimore, këto parime dhe norma kanë ndërtuar një realitet shoqëror, brenda të cilit ato i japin shumë rëndësi mënyrës si t'i thonë gjërat. Prandaj, femrat e menaxhojnë sjelljen e tyre gjuhësore, me qëllim që t'u përshtaten këtyre normave, e si rrjedhojë e kësaj t'i ruajnë ose t'i krijojnë pozicionet e tyre në shoqëri.

Fjalë kyçe: gjuhë e femrave, sociolinguistikë, analizë e diskursit, deficit gjuhësor, dominim gjuhësor, dallim gjuhësor, stigmatizim, imazh

SUMMARY

This dissertation addresses the way women communicate, the language choices they make, the function of these choices, the social factors influencing their linguistic behaviour, and their position in society. In addition, it addresses the social problems that may arise due to the language such as language inequality as a consequence of social inequality, barriers, prejudices, and stereotypes as a potential source of prejudice, etc. In other words, we have tried to find out how women deal with their linguistic behaviour, or the strategies they use to adapt to norms and principles of social mentality in order to maintain or create certain positions in society.

This study's analysis has been conducted based on different methods, mainly direct observations on women and men's conversations developed in different contexts, in addition to other methods describing their language. We have made the distinction, not only between speakers of different ages and levels of education, but also between women and men. There have been noticed links between language organization and social factors as well as other social problems that may arise due to language.

The data collected were verified through various sociolinguistic questionnaires or surveys. In addition to analyzing the linguistic differences, the results on stereotypes, sexist prejudices and labels for estimating or accepting these stereotypes and labels, and the reactions of the labeled people and the impact they have on success and their position in society have been derived. In a word, through this method we have attempted to identify the ways women are portrayed by these defining units.

The examples we used in this study were obtained from respondents of different genders, different ages, and different educational levels, specifically from conversations held in different settings: school, family, social, TV shows, etc.

To address these issues, first of all we provided a general overview of women's language and the viewpoints of foreign and Albanian researchers. Based on these studies, we have built the theoretical basis to carry on with women's language in our corpus.

While analyzing texts, direct observations, and surveys of the study subjects, we came to the following conclusions:

- The differences between men and women are of different levels: phonetic (intonation, rhythm, sound quality, accent, etc.), morphological (verbs, pronouns, adjectives, adverbs, interjections, particles, etc.), syntactic (types of sentences, etc.), lexical and stylistic (greetings, curses, offensive words, words of kindness and apology, euphemisms, threatening words and expressions, words and expressions with exciting hues, words with figurative meanings, etc.), and text or conversation construction in general (conversation queue, conversation interruption, speech density, etc.).

- Women and men use certain language forms to achieve different effects or goals in communication. While women use linguistic units expressing solidarity, insecurity, suspicion, acceptance, politeness, confusion, reluctance, indecisive attitude, lack of determination, hesitation, confirmatory support, punctuality, accuracy, timidity, modesty, feelings, or emotional attitudes (anger, fear, pain, despair, amazement, love, joy, pleasure, longing, remorse, irony, enthusiasm, shame, etc.), aesthetic feelings, etc. much more, men, on the other hand, use language units expressing power-authority, security, severity, demands, etc.

- Power and solidarity are manifested through certain linguistic features: phonetic / phonological (differences in sound pitch, decline, and force, differences in words pronunciation or accentuation, differences in the speed of their pronunciation, etc.), morphological (modes of verbs, adjectives, adverbs, interjections, particles, etc.), syntactic (exclamatory sentences, interrogative sentences particularly rhetorical-interrogative sentences, exclamatory categorical sentences, short answers, positive sentences expressing uncertainty, explanatory and modifying phrases, simple and incomplete-elliptical sentences, etc.), lexical and stylistic (curses, congratulations, taboo words, euphemisms, words of kindness and apology, threatening words and expressions, etc.), text or conversation construction (conversation queue, conversation interruption, speech density, etc.).

- Women typically use indirect communication forms, whereas men use direct communication forms. The former use these communication tools to achieve different goals, i.e. to speak in a more correct, complete, polite and agreeable manner to interlocutors, to attract

attention, to influence others, to have fun or to ridicule someone, to say things that, for various reasons, mostly not to break the social code or ethical code cannot be said directly, and thus manage to cover the expressive gaps that may be created because of these norm systems. By adhering to moral standards or principles, they manage to create or maintain a better image in society.

- Women use euphemistic words and expressions much more than men. Among the most common are those that reflect magical-mystical viewpoints and phenomena of the spiritual and psychic life of human, euphemisms formed on the basis of dogmas or mystical-religious prejudices, euphemisms associated with various processes or diseases, particularly euphemisms that replace the taboo words. Of the 72 such units found in our corpus, 65% were used by women, whereas 35% were used by men. Most of the euphemistic expressions identified, specifically 73% were used by women to replace certain intimate parts of the body, pregnancy, menstruation, physiological needs, sexuality, etc. However, far less, namely 27% are euphemisms related to beliefs in divine and supernatural powers with different processes or diseases.

Women, just like men, use words and expressions to nickname, insult, or express bad thoughts about others. However, such words and expressions differ from the insults men use, both in content and circumstances. These units are mostly used by women with higher education, women with lower social status, young and old women (less by middle-aged women), the ones who completed lower and upper secondary education only, and the women of high social status. Thus, the use of taboo words, in addition to gender, is related to social status, speaker's age, the context of communication, as well as the relationships between people involved in communication.

- Women use irony as a form of indirect communication, especially in cases where they express anger, contempt, disregard, underestimation, disdain, hatred, etc., much more than men. They accomplish this form of communication mainly through exciting interjections, diminishing suffixes associated with a sense of contempt, and so on.

- Women language is also filled with words of figurative sense, such as forms of indirect communication, especially comparisons, hyperbole, epithets, personifications, etc. Thus, while communicating, they aim to provide a clearer picture of what they mean in order to be more

understandable and accessible to their interlocutors, emphasize their opinion, or make a greater impression on something.

- Women are also distinguished from men by the way they express demands or the way they approach to the others to perform an action or solve a problem. Thus, men are more likely to use direct communication style through categorical exclamatory sentences, whereas women are more likely to use indirect communication style through non-categorical exclamatory sentences, though such sentences are found in men's language, especially in cases where they tend to have a softer attitude, break down the barriers and be closer to their interlocutors, or audience, and thus influence them more.

- The use of categorical exclamatory sentences is more related to the contexts of communication, the role that speakers have in these situations, the relationships between them, the affective attitude towards what they say or the demands they make, that is, their emotional state, as well as the authority they enjoy. Given that men, in most cases, are in higher hierarchical positions and are more authoritarian, categorical exclamatory sentences, through which direct, indisputable, or categorical orders are given, are more typical of their discourse. However, since authority is not exercised by power only or the compelling force to exercise power over the others in order to persuade or compel them to respond to our calls or requests, in many cases it is related to honour, respect and trust that exists between members of a group. Unequal social relations of power or dependence are not always reasons for the use of indirect communication style. On the contrary, in many cases, meeting a demand without directly making it is a sign of power, not of its lack; it is a communication system through which both parties seek to preserve respect and image.

- Women are more likely to use the standard variety, while men are more likely to use the non-standard variety. The factors that influence the use of one or the other variety are of different nature. The former use the standard language more in order to maintain their distance with officials, be more cautious, show more respect, make better impressions, arouse conviction and confidence that they are competent, be better valued, improve their image and thus regulate their position in society. This means that such selection occurs under the pressure of different standards by which men and women are valued. While men are more valued for their profession

or skills, the same is not applied for women. They are most valued for other status features, including speech.

- The interruption of conversation (overlapping) as well as talkativeness or silence depends on a number of factors. It does not always appear as a speakers' attempt to show power over the interlocutors. In many cases speech disruptions depend on the communicative competence of the speaker (the speakers do not have sufficient knowledge to provide facts about the problem being discussed, or they do not know verbal and nonverbal communication strategies, which increase communication efficiency), goals which are intended to reach the interlocutors during the discussion (the speakers deliberately interrupt the other party, leaving no space for expressing their ideas), their emotional state (the speakers, either fail to express their ideas clearly or accelerate the pace of speech), cultural issues (the respect for interlocutors), relationships between speakers (the attitude the speakers hold towards each other, the respect and authority of the speakers involved in the conversation), etc.

- Stereotypes and sexist labels on women, and other problems related to them such as prejudice and stigmatization, are also more typical for women than men. They are, in many cases, the result of unconscious beliefs, since they are often created, passed down from generation to generation unconsciously, and then are accepted as true or fair estimation for different individuals and groups, particularly for women. However, most of them are product of the conscious beliefs that people create for these categories. Given that such units derive from the philosophical, moral, religious, aesthetic thoughts of certain social layers, they reflect the interests and attitudes of these layers. Therefore, estimations based on such views are given to achieve different goals: to control, oppress, despise, insult, and above all express superiority over the others.

- Based on the content of stereotypes and labels about women drawn from our corps, we have come to the conclusion that most of women carry out negative beliefs or attitudes about them. The majority of such units express these attitudes quite explicitly such as hatred, contempt, anger, reproach, irony, ridicule, despair, contempt, resentment, disappointment, disbelief, hostility, envy, jealousy, disgust, and many other attitudes of contempt for women. The results show that women are most often rated as intriguing, loyal, cunning, curious, capricious, emotional, honest, fair, loving, kind, cooperative, friendly, submissive, naive, gentle, indecisive,

quarrelsome, talkative, polite talkers, gossipers, indirect talkers, and conversation interrupters. On the other hand, men are more often portrayed as intelligent, competitive, ambitious, logical, strong, principled, dominant, exploitative, deceitful, arrogant, materialistic, vigilant, successful, hard-working, independent, courageous, strict, aggressive, etc.

- Such negative stereotypes and labels ideologically justify the inferiority of women in society. Therefore, through these linguistic units, speakers tend to reject women's value or advantage and thus put them in lower social positions.

- The stereotypes and labels in the reviewed texts, especially those of folklore, have revealed that they are not merely offensive. Rather, they are calls towards contempt, disdain, inequality, discrimination, stigmatization, and violence against women. Therefore, such stereotypes and labels have a major impact on the rise of sexist attitudes. Thus, one of the factors that play a major role in increasing prejudice and stigmatization may be the exposure to discriminatory messages that these texts convey to women.

- Stereotypes and labels in the texts reviewed are not always based on negative attitudes and opinions about women. In some cases they are based on kindness, caring, admiration, gratitude, compassion, praise, or love for them. However, even in such situations, they make a link between inferior treatment and positive evaluation for women. This means that in any case, despite referring to women who hold different roles, they generally give an overview of their inferior position in society. Thus, the use of words expressing love or affection in formal situations (darling, baby, sweetheart, etc.) is discriminatory. They are discriminatory and offensive as they aim to achieve closeness or intimacy.

- Perceptions and the degree of stereotypes are closely related to individuals' knowledge on certain social categories. The less they know about someone or something, the more likely they are to generalize and prejudice on them. During the research we have noticed that women who have not established a certain career are more prejudiced than women with high positions in society, so stereotypes are more common among different groups than within the same group, exactly due to the lack of this information. This fact is a clear indication that stereotypes influence our behaviours, judgments, and evaluations. In other words, stereotypes have the

power to control or dictate our behavior, in addition to our judgments and evaluations of someone or something.

- There are marked differences in the attributes of women of different categories: of different ages, of different educational levels and of different regional and social layers. Thus, the same women are portrayed or valued in different ways. This means that, in addition to gender, such stereotypes and labels are closely related to other factors, such as age, education, background, social status, and so on.

- During research we have found that the areas of politics, economics, sports and opinion / editorial, areas where women are viewed as incompetent, best reflect the great differences between women and men, not only in the media and these fields, but also in society in general, as the media reflects only the real state of their position in society. In other words, this clearly reflects, but also reinforces the already mentioned stereotypes that portray women as weaker leaders than men, less capable in politics and activities that require stronger physical training (sport), and in making judgments or evaluations on certain issues. On the other hand, the very presence of women in the show biz is a clear indicator that they are seen as worthy of the entertainment world. In other words, it shows that women are, in most cases, treated in a fun and erotic way, and rarely in a professional one.

- Stereotypes and labels given to women are rated much more negatively compared to the ones given to men. Thus, if we refer to the results of the surveys on the acceptance or rating of these stereotypical traits, we can conclude that out of the 44 traits, 25 are positive (12 traits are typically rated to women and 13 to men), 18 are negative (11 to women and 7 to men), while one is considered neutral (common to both sexes). This indicates that stereotypical traits and labels attributed to women are rated more negatively (61%) than those attributed to men (39%). Of the 25 positive traits, 48% were attributed to women and 52% to men.

Based on all these results, we can finally say that the linguistic differences between men and women reflect social relationships, and they are shaped and changed in accordance with the changes in these relationships. These differences are of different nature; different culture, personality, attitude, insecurity, authority, emotional state, lifestyle, appreciation, social factors (family, social environment, school, and other principles and standards of mentality), etc.

Women's texts fit and reflect social reality as much as they intend to build it up. In other words, their linguistic behaviour is an expression of their way of life, their viewpoints, traditions, mentality, character, education, norms, principles of social mentality, etc. These viewpoints awareness, principles, and norms have built a social reality, where they attach great importance to the way they say things. Therefore, women manage their linguistic behaviour in order to conform to these norms and thus maintain or create their own positions in society.

Key words: women's language, sociolinguistics, discourse analysis, language deficits, language dominance, language difference, stigmatization, image

